



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 11.9.2019

Dokument parlamentar

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROJEKTIN
PËR LEHTËSIMIN E TREGTISË DHE TË TRANSPORTIT NË BALLKANIN
PERËNDIMOR ME QASJE PROGRAMATIKE ME SHUMË FAZA”**

- ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 11 shtator 2019, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”. Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj z. Vullnet Sinaj.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, Zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit.***

Këshilli i Ministrave e paraqiti projektligjin bazuar në nenet 81, pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, si

dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.***

Marrëveshja, që propozohet të ratifikohet me këtë projektligj, ka qëllim marrjen e një huaje nga BERZH prej 17.6 milionë eurosh, e cila do të përdoret për realizimin e projektit për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor. Objektivi kryesor i këtij projekti është reduktimi i kostove të tregtisë dhe rritja e efikasitetit të transportit në vendin tonë dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet një angazhimi afatgjatë dhe të vazhdueshëm.

Projekti parashikon masa për rritjen e lehtësisë së lëvizjes së mallrave, nëpërmjet modernizimit të doganave dhe rritjes së bashkëpunimit ndërmjet tyre, kryerjes së veprimeve me një sportel, përmirësimit të sistemit të teknologjisë së informacionit, përmirësimit të kapacitetit fizik dhe të kushteve të punës në pikën kufitare të Qafë Thanës etj. Rritja e efikasitetit dhe e parashikueshmërisë së transportit do të arrihet nëpërmjet përmirësimit të monitorimit të trafikut të anijeve. Projekti do të mbështetet me asistencën teknike të nevojshme për zbatimin e reformave rregullatore dhe institucionale. Një komponent i rëndësishëm është edhe mbështetja që do të jepet për strukturat zbatuese të projektit.

Ky projekt është pjesë e fazës së parë të programit të përbashkët në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Programi përfshin dy faza, secila prej të cilave do të zbatohet për një periudhë 5-vjeçare. Faza e parë përfshin Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, të cilat janë konsideruar të gatshme për zbatim. Faza e dytë përfshin vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Programi përfshin një kombinim të investimeve, asistencës teknike, si dhe reformave rregullatore e institucionale.

Huaja, që do të merret nga BERZH, ka termat si më poshtë;

- | | |
|--------------------------|--|
| - Shuma e huasë | 17.6 milionë euro; |
| - Interesi | bazuar në normën e referencës plus marzh të pandryshueshëm; |
| - Tarifa front-end | 0.25 për qind e shumës së huasë; |
| - Komisioni i angazhimit | 0.25 për qind mbi vlerën e padisbursuar të huasë; |
| - Maturimi | 23 vjet, duke përfshirë periudhën prej 7 vjetësh pa pagesë principali. |

Marrëveshja parashikohet të realizohet gjatë periudhës 2019-2025. Ky projekt do të përfshihet në PBA 2019-2021.

- ***Diskutimi në Komision.***

Relatori paraqiti projektligjin, duke vënë theksin në rolin që ai do të luajë në zhvillimin e tregtisë dhe transportit të vendin tonë.

Zëvendësministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë paraqiti një informacion të detajuar për projektligjin dhe objektivat përkatëse.

Gjatë diskutimit anëtarët e Komisionit e konsideruan marrëveshjen mjaft të rëndësishme, pasi ajo krijon mundësitë financiare për lehtësimin e lëvizjes së mallrave dhe rritjen e efikasitetit të transportit në vendin tonë, si dhe në raport me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Ajo do të kontribuojë në rritjen e investimeve, zhvillimin e tregtisë dhe të ekonomisë në përgjithësi. Projekti i parashikuar në këtë marrëveshje, është një ndër projektet më innovative të Bankës Botërore dhe një nga shtyllat kryesore të procesit të Berlinit, i cili u vjen në ndihmë vendit tonë dhe vendeve të tjera të Ballkanit perëndimor që të arrijnë progres në ndërlidhjen ekonomike dhe infrastrukturore ndërmjet tyre. Nëpërmjet këtij projekti synohet modernizimi i sistemit doganor, për të bërë të mundur uljen e kostonë së transaksioneve tregtare, uljen e kohës së zhdoganimit të mallrave dhe përmirësimin e bashkërendimit midis agjencive doganore.

- ***Përfundim.***

Në përfundim, Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje, me një ndryshim, si më poshtë:

Në nenin 1 të projektligjit, rreshti i parafundit, hiqen fjalët “në shumën 17 600 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) euro”.

RELATORI

Vullnet Sinaj

KRYETARI

Arben AHMETAJ